



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:290913
Datë: 17.05.2024
Numri i dokumentit: 05700393

AA.nr.534/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrativ, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Hajriz Hoti kryetar i kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Delushe Halimi anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Hajrije Krasniqi, në çështjen e konfliktit administrativ sipas padisë së paditëses, Komuna e Prizrenit, të cilën me autorizim e përfaqëson, Blerim Mazreku, avokat nga Prizreni, kundër të paditurës, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative A.nr.3013/19, të datës;20.02.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë;13.05.2024 merr këtë,

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditëses, Komuna e Prizrenit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.3013/19, të datës;20.02.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.3013/19, të datës;20.02.2023, është vendosur, “*REFUZOHET si e pabazuar, kërkesëpadija e paditësit Komuna e Prizrenit –Drejtoria e Inspektorateve, Sektori i ndërtimit, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të të paditurës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me numër A-144/19 të datës 31 tetor 2019.*”

Kundër këtij aktgjykimi paditësja ka ushtruar ankese, përmes të autorizuarit të saj, Blerim Mazreku, avokat nga Prizreni, me të cilin konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, të ndryshohet ose që aktvendimi i ankimuar të prishet dhe çështja t’i kthehet në rivendosje Gjykatës së shkallës së parë.

E paditura, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 paragrafi d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe ka gjetur se ankesa e paditëses është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kundërshtuar, nr.A-144/19, të datës;31.10.2019 të paditurës, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë është aprovuar si e bazuar ankesa e B.K, Komuna e Prizrenit, dhe paditëses Komuna e Prizrenit i është anuluar aktvendimi me nr.17-352-88236 i datës;04.07.2029, me arsyetimin se Komuna e Prizrenit-Drejtoria e Inspektoreve ka bërë shkelje të Ligjit për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje.

Paditësja e pa kënaqur me vendimin e të paditurës, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë, kanë ushtruar padi për konflikt administrativ, me datë;16.02.2019, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditëses të paraqitur kundër vendimit kontestues të paditurës, dhe administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin kërkesëpadinë e paditëses e refuzon si të pa bazuar, me arsyetim se “Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 44 par.1 të LKA-së, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve ne padi, përgjigje ne padi, shkresave të lëndës në këtë çështje administrative, dhe thënieve ne seancën e shqyrtimit kryesor, ka gjetur se padia e paditësit është e pabazuar. Me vendimin e kontestuar me padi, është konstatuar se paditësja, Komuna e Prizrenit, ka ndërmarrë veprime për rrënimin e etazhës së ndërtuar pa leje nga ana e palës me interes juridik B.K,. Pala me interes juridik ka deklaruar se paditësja ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, pasi që i njëjti ka aplikuar për legalizim të këtij objekti, ndërsa paditësja nuk ka ofruar prova me të cilën do të vërtetohet e kundërta. Neni 2 i Ligjit Nr. -6/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, ka përcaktuar se: “1. Ky ligj është i aplikueshëm për të gjitha ndërtimet pa leje që janë ndërtuar ose kanë filluar të ndërtohen pa leje deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji. 2. Ky ligj nuk është i aplikueshëm për ndërtimet e regjistruara në Kadastër dhe Regjistrin e të Drejtave në Pronë të Paluajtshme në kohën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji. 3. Ndërtimet sipas paragrafit 2. të këtij neni konsiderohen të jenë të ligjshme dhe për to nuk kërkohet trajtim sipas këtij Ligji. Megjithatë nëse ndërhyrjet pa leje janë bërë pas regjistrimit të ndërtimit në Kadastër, ndërhyrjet pa leje trajtohen në pajtim me nenin 16 të këtij Ligji. 4. Ky Ligj nuk është i aplikueshëm për ndërtimet pa leje që kanë filluar pas datës së hyrjes në fuqi të këtij Ligji. 5. Ky Ligj nuk është i aplikueshëm për ndërtimet të cilat posedojnë leje ndërtimore dhe nuk janë në kundërshtim me lejen ndërtimore, por që u mungon vetëm certifikata e përdorimit ose leja e përdorimit. 6. Ky Ligj nuk është i aplikueshëm për objektet e trashëgimisë kulturore të përfshira në listën e trashëgimisë kulturore sipas Ligjit në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe të cilat konsiderohen të jenë të ligjshme”. Ky ligj po ashtu ka përcaktuar edhe procedurat e parashtrimit të kërkesave për legalizim të objekteve, si dhe procedurat e vendosjes për secilën kategori të kërkesave. Paditësja nuk ka dhënë arsyetim të qartë lidhur me kërkesën e palës me interes juridik, Nr. 04 – 353/01 – 0144294/18 të datës 24.09.2018. Sipas shkresave të lëndës, vërtetohet se paditësja ka ndërmarrë veprime për rrënimin e objektit, pa u shqyrtuar fillimisht kërkesa e palës për legalizim, nëse kjo kërkesë i plotëson apo jo kushtet për t’u aprovuar apo edhe refuzuar. Mbi këtë bazë, gjykata gjen se vendimi i të paditurës lidhur me këtë konstatim, është i drejtë dhe i ligjshëm si dhe i bazuar në gjendjen faktike, andaj pretendimet e paditëses lidhur me këtë fakt i vlerësoi si të pabazuara sepse janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e

organit të paditur dhe në kundërshtim edhe me provat e lartpërmendura. Paditësja po ashtu, me padi ka kundërshtuar konstatimet e të paditurës se gjatë procedurës së rrënimit, palës me interes juridik i janë shkaktuar dëme materiale për shkak se nuk janë ndërmarr asnjë veprim sigurie, ndërsa nuk ka bashkëngjitur prova relevante me të cilat do të argumentonte këtë pretendim. Andaj, në bazë të provave të administruara në procedurë si dhe dispozitave ligjore, gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative nga ana e të paditurës drejtë është vërtetuar gjendja faktike dhe se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara nuk ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale janë vërtetuar plotësisht e që nga faktet e vërtetuara është nxjerrë vendim i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike.”

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kolegji i apelit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës së konfliktit administrativ, sipas vlerësimit të kolegjit të apelit ky pretendim nuk qëndron, ngase ankuesi të njëjtës shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk ka theksuar saktësisht se ku qëndrojnë shkeljet e dispozitave të procedurës së konfliktit administrativ, megjithatë kolegji i apelit vëren se Gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPK-së, LKA-së, dhe se aktgjykimi është hartuar në pajtim me nenin 160 të LPK-së.

Sa i përket pretendimit ankimor për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se *“Me rastin e marrjes së këtij vendimi MMPH nuk merr parasysh asnjë provë dhe fakte të paraqitura nga ana e Komunës së Prizrenit madje e njëjta thirret në atë se K... si investitor ka paraqitur kërkesën për legalizim të katit të VIII-të, mirëpo nuk e merr për bazë datën e paraqitjes së kërkesës për legalizim sepse Ligji për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje ka hyrë në fuqi me datë 2018, ndërsa investitori kërkesën e tij e ka parashtruar me datë 07.06.2019”*. Kolegji i apelit duke i vlerësuar këto pretendime ankimore, vëren se gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, kjo për faktin se Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditëses ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditëses janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, kur ka konstatuar se *“Paditësja nuk ka dhënë arsyetim të qartë lidhur me kërkesën e palës me interes juridik, Nr. 04 – 353/01 – 0144294/18 të datës 24.09.2018. Sipas shkresave të lëndës, vërtetohet se paditësja ka ndërmarrë veprime për rrënimin e objektit, pa u shqyrtuar fillimisht kërkesa e palës për legalizim, nëse kjo kërkesë i plotëson apo jo kushtet për t’u aprovuar apo edhe refuzuar”*.

Prandaj, për këto arsye kolegji i apelit vlerëson se janë të pa bazuara pretendimet ankimore për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, ngase provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Sipas vlerësimit të kolegjit të apelit gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë, nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, kjo për faktin se aktgjykimi i ankimuar nuk

është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike. Gjithashtu vendimi është bazuar në zbatim të drejtë të së drejtës materiale.

Prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të apelit, aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsyet e mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kolegji i apelit.

Duke vlerësuar se Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditëses, dhe mbi këtë bazë ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.534/2023, datë;13.05.2024

Kryetari i kolegjit,
Hajriz Hoti